



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Dhuanan efektivet te Kuvendi, organizatorët e protestës akuzo

Policiat: Po shndërrorësh në instrument politik! Shqiptar shqiptare në Britani: Qeveria të dialogojë me protestuesit
- 2

Përplasjet për aeroportin e Vlorës, Pacolli: Hiqen kufizimet për VIA-n, asnjë vendim gjyqësor nuk pengon më përfundimin e punimeve
- 3

FOTO/ Provokime dhe kërcënime, ky është protestuesi që sulmon gazetarët
- 4

Merr flakë makina në Vlorë, shoferi i hedh paq dhe del në kohë
- 5

Arrestimi jo proporcional, përfaqësuesit ligjorë të Veliajt për vendimin e Kushtetueses: Gjykata e Lartë të urdhërojë lirimin e menjëhershëm

Kronikë

Mirditë/ Vritet me breshëri plumbash në makinë 45-vjeçari, dyshohet si i përfshirë në vrasjen e Anton Kelit! Ishte punonjës i kompanisë së bazaltit në Spaç, iu vendos tritol para disa muajsh (EMRI)

Në Spaç të Mirditës u vra në atentat Valter Lleshi, 45-vjeç. Autorët ende s'janë identifikuar ndërsa në vendngjarje u gjetën 18 gëzhoja. Po hetohet pista e hakmarrjes. Ai ka qenë i dyshuar si i implikuar në vrasjen e Anton Kelit, kushëririt të Preng Gjinit. Për ngjarjen e 2020-es nuk u gjetën prova dhe ai nuk u procedua penalisht.

■ Vrasja e 45-vjeçarit në Mirditë, dyshohet se u ekzekutua për hakmarrje!

Mirditë/ Vritet me me breshëri plumbash brenda në automjet 45-vjeça
Report TV



Watch on

Elvis Hila
15 Qershor, 08:03 | Përditësimi: 15 Qershor, 13:46




Valter Lleshi, baba i dy fëmijëve, u ekzekutua me breshëri kallashnikovi mëngjesin e së hënës në Reps të Mirditës. 45-vjeçari po udhëtonte me një automjet të kompanisë "Balkan Basalt", ku punonte, kur iu bë atentat në një rrugë rurale pa kamera sigurie.

Sipas burimeve nga vendngjarja, Lleshi u qëllua me breshëri plumbash dhe mori plagë të shumta në kokë e trup. Në vendngjarje u gjetën 18 gëzhoja. Trupi i tij u gjet nga një koleg që po shkante në punë, i cili njoftoi menjëherë policinë. Pika kontrolli janë ngritur në të gjithë zonën dhe po kryhen kërkime intensive, edhe me qen gjurmues, për identifikimin e autorëve.

Tre muaj më parë, në kamionin që drejtonte Lleshi u gjet lëndë plasëse që nuk shpërtheu. Ai njoftoi policinë dhe deklaroi se nuk kishte konflikte, por dyshonte se tritol mund të ishte një mesazh ndaj kompanisë. Ngjarja po verifikohet nëse ka lidhje me atentatin e sotëm.



LEXO EDHE:
Suedi/ Vritet me armë i riu nga Kosova, dyshohet viktimë e përplasjes së bandave kriminale



Megjithëse 45-vjeçari nuk kishte precedentë penalë, hetimet janë përqendruar te lidhjet e tij shoqërore me fisin Reçi, i cili prej tre dekadash është në konflikt me fiset Gjini dhe Bardhi në **Mirditë**.

Pikërisht për shkak të këtyre lidhjeve dhe dinamikës së konfliktit të vjetër, hetuesit po verifikojnë nëse atentati lidhet me vrasjen e Anton Kelit në dhjetor 2020 në Rrëshen. Keli ishte kushëri i Tonin dhe Preng Gjinit. Sipas burimeve policore, Lleshi ishte i dyshuar asokohe, por nuk u procedua, pasi nuk u gjetën prova që e implikonin në krim.

Hakmarrja mes fiseve Reçi, Gjini dhe Bardhi konsiderohet një nga sagat më të përgjakshme në veri të vendit. Në vitin 1995 u vra Ilir Reçi. Një vit më herët, Dod Gjini kishte vrrarë shefin e Krimeve, Ndue Kaza, i cili kishte ndërhyrë për të ulur tensionet mes palëve. Në vitin 1997 u krimev Dod dhe Agustin Gjini, ndërsa më pas u ekzekutua edhe Nikolin Gjini në burgun e Shënkollit.

Në vitin 2016 u vra Saimir Jaku, ndërsa më 28 prill 2017 Gasper Reçi u ekzekutua në Romë. Pesë muaj më pas, në Belgjikë u vra Kreshnik Gjini. Në gusht 2018 u plagos Arben Gjini, ndërsa më 13 gusht 2019 u vra Armando Gjini në qendër të Rrëshenit. Më 7 janar 2020 u ekzekutua Kastriot Reçi me snajper në Rrëshen. Në shtator të po atij viti, Preng Gjini i shpëtoi një atentati me eksploziv në Tiranë.

Më 15 dhjetor 2020 u vra **Anton Keli**, ngjarje që po verifikohet edhe në lidhje me atentatin e së hënës ndaj Valter Lleshit. Në mars 2023, Saimir Reçi i shpëtoi një atentati në Rrëshen, ndërsa gjashtë muaj më vonë u vra Martin Bardhi. Në vitin 2025 u vra edhe nipi i tij, Kristian Marku (Bardhi).

Hetuesit po verifikojnë nëse vrasja e Valter Lleshit është episodi më i fundit i këtij konflikti shumëvjeçar mes fiseve rivale në Mirditë, i cili ka lënë të paktën 14 viktima dhe disa të plagosur.

Rendit zhvillimet sipas orarit: **Te Fundit**

Ora 12:23
U ekzekutua me breshëri plumbash brenda në automjet, del foto e viktimës në Mirditë! Dyshohet se u vra për hakmarrje



Report Tv ka siguruar foton e 45-vjeçarit Valter Lleshi, i cili u vra me breshëri plumbash brenda një automjetin e kompanisë ku ishte i punësuar. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në fshatin Shkorret, përgjatë rrugës Reps–Spaç rreth orës 07:10 të mëngjesit sot.

Një prej pistave që po hetohet është ajo e hakmarrjes pasi dyshohet se viktimat të ketë qenë i përfshirë në vrasjen e Anton Kelit në Rrëshen. Keli rezultoi të ketë qenë i afërm i Armando Gjinit. Megjithatë, burime nga policia sqarojnë se deri më tani Valter Lleshi nuk ka qenë i hetuar dhe as i skeduar si i dyshuar për vrasjen e Anton Kelit.

K.B/Shqiptarja.com **f Share**

Ora 10:31
Vrasja e 45-vjeçarit në Mirditë, dyshohet se u ekzekutua për hakmarrje!



Foto: Policia në vendin e ngjarjes

45-vjeçari Valter Lleshi dyshohet se është ekzekutuar për motive hakmarrjeje. Burime pranë grupit hetimor bëjnë me dije se ai njihej për lidhjet miqësore me fisin Reçi.

Një nga pistat që po hetohet është edhe një dyshim i hershëm për përfshirjen e Lleshit në vrasjen e Anton Kelit në Rrëshen. Keli rezultoi të ketë qenë i afërm i Armando Gjinit.

Megjithatë, burime nga policia sqarojnë se deri më tani Valter Lleshi nuk ka qenë i hetuar dhe as i skeduar si i dyshuar për vrasjen e Anton Kelit.

Hetimet vijnë për të zbardhur motivin e krimit dhe për të identifikuar autorët.

Xh.K/Shqiptarja.com **f Share**

K.B/Shqiptarja.com

TAG: **vrasje** **Lezhe** **mirdite** **valter lleshi** **Anton Keli**

Komento

Komente

serxho: 15/06/2026 12:03

Nuk heqin dorë malokët nga vrasjet dhe vetgjiqësia.

Tosi: 28/06/2026 21:18

Maloket i duan dhe i respektojnë shume familjet e tipave si puna jote, laluc.

Ndaloheh rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Sipas jush, protesta te Kuvendi a ka qenë e dhunshme nga ana e protestuesve?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera




Zjarr pranë plazhit të Tales në Lezhë!
Punohet për shmagjen e flakëve drejt banesave dhe bizneseve (VIDEO)

5 Korrik, 12:21



I dënuar për vrasje në Fier, arrestohet në Greqi shqiptari! Në kërkim prej tre dekadash!

5 Korrik, 11:50



Kurbin/ Shkrumbohen pesë mjete të tonazhit të rëndë në një gurore në Shpërdhet, zjarrt dyshohet i qëllimshëm

5 Korrik, 11:24



Dogji mbeturinat pranë biznesit të tij dhe i vuri flakën malit të Shëngjinit, pranga 57-vjeçarit! Fshiu DVR-nën e kamerave të sigurisë për të fshehur provat (EMRI)

4 Korrik, 14:57




Lezhë/ Vihet nën kontroll zjarri në malin e Shëngjinit, digjen sipërfaqe të konsiderueshme! Arrestohet 57-vjeçari (EMRI + VIDEO)

4 Korrik, 07:26



Zjarr në malin e Shëngjinit, debat për kamerat në Këshillin Bashkiak, PD: Cenojnë privatësinë! Ndreu: Janë vendosur për të parandaluar shkeljet

3 Korrik, 21:27




Shkarkime nga HEC-et, Miloti s'u shpëton përmbytjeve as në verë! Në Fier nis rehabilitimi i argjinaturës së lumit Vjosa

Elvis Hila

Marsela Topi


3 Korrik, 16:11



Masakra e Velipojës, arratiset Hasan Ferracaku, 'zhduket' nga banesa ku ruhej 24 orë nga policia! Arrestohen 4 efektivë

Ergys Kavaja

2 Korrik, 13:39



Pastrimi në Lezhë, debat për kamerat në Këshillin Bashkiak, PD: Cenojnë privatësinë! Ndreu: Janë vendosur për të parandaluar shkeljet

Elvis Hila

1 Korrik, 13:39



I akuzuar për vrasjen e policit Xhulio Prela në Lezhë në 2020, Apeli konfirmon pafajësinë për Redion Hysën! Arma e krimit u gjet në depozitën e ujit pranë banesës së tij

30 Qershor, 16:46



Aksion per hapësirat publike në Shëngjin, hiqen shezlonget e subjekteve private që kishin zaptuar plazhet

Elvis Hila

30 Qershor, 11:45



Shkoi të rregullonte dritat te shtëpia e vjehrrit, 45-vjeçarin e zë rryma elektrike dhe humb jetën

Elvis Hila

29 Qershor, 15:16

Lajmi i fundit
Tepelena nga protesta: SPAK të veprojë mbi 'Albania Files', deputetët e PS të largohen nga Rama

6 Korrik, 21:20

